

20060130182

L I G J
PËR GARANCINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SIPAS MARRËVESHJES PËR
HUA TË LIDHUR NDËRMJET BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM DHE NP ELEKTROEKONOMIA E MAQEDONISË PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT NË SEKTORIN E ENERGJETIKËS

Neni 1

Republika e Maqedonisë garanton përmbushjen e obligimeve sipas Marrëveshjes për realizimin e Projektit për sektorin e energjetikës, të lidhur më 22 dhjetor 1993 ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe NP Elektroekonomia e Maqedonisë.

Marrëveshja për hua e paragrafit 1 të këtij neni është lidhur në shumë iniciale prej 46. 500 000 markash gjermane.

Nga shuma iniciale, më 30 nëntor 1997 është hequr dorë në 12. 594. 574, 63 marka gjermane, me çka borxhi ndaj Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim i krijuar me nënshkrimin e Marrëveshjes për hua, të cilën e garanton Republika e Maqedonisë, është 33. 905. 425, 37 marka gjermane.

Neni 2

Të gjitha obligimet financiare sipas bazës së kamatës dhe provizionit nga Marrëveshja për hua e nenit 1 të këtij ligji, si dhe servisimi i pjesës së mbetur të kryegjësë nga huaja në shumën prej 5. 461. 522 euro, do t'i mbulojë ShA MEPSO – “Operator i sistemit elektropërçues të Maqedonisë”, ShA për përçimin e energjisë elektrike dhe administrim me sistemin elektroenergjetik, në pronësi shtetërore – Shkup, nga të ardhurat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 3

Huaja nga neni 1 i këtij ligji paguhet si vijon:

Afati i pagesës është 12 muaj me një grejs periudhë prej tri vjetësh dhe shkallë variabile të kamatës – LIBOR gjashtëmujor plus 1%.

Huaja paguhet në këste të barabarta gjysmëvjetore të cilat arrijnë për pagim më 10 janar dhe 10 korrik çdo vit, duke filluar prej 10 korrik 1997, e duke përfunduar më 10 korrik 2009.

Neni 4

Nëse detyrimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e përcaktuara me Marrëveshjen për hua, në emër të ShA MEPSO i paguan Republika e Maqedonisë, ShA MEPSO është e obliguar që në afat prej 30 ditësh, prej ditës së zbatimit të obligimit të transferojë, në dobi të llogarisë së hyrjeve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, mjete në denarë në lartësinë e pagesës së bërë, të rritur për kamatën e përlllogaritur dhe shpenzimet e bëra lidhur me transaksionin përkatës.

Ministri i Financave mund të lëshojë urdhëresë te Drejtoria e të Hyrave Publike për bllokimin e mjeteve të ShA MEPSO në bazë të kthimit të TVSH-së me qëllim që të përmbushen obligimet e arritura ndaj kreditorit, përkatësisht t'i kompensohen shtetit mjete në denarë në lartësinë e pagesës së bërë, të rritur për kamatën e përlllogaritur dhe për shpenzimet e krijuara lidhur me transaksionin përkatës.

Neni 5

ShA MEPSO prej të hyrave të veta, çdo vit fiskal në kohën e vlefshmërisë së Marrëveshjes për hua, në fondin rezervë të formuar për realizimin e programit për zhvillim, do të sigurojë dhe shpërndajë mjete financiare në një shumë prej 5% të të hyrave bruto, të cilat arkëtohen për shërbimet e dhëna për përçimin e energjisë elektrike dhe administrimin me sistemin elektroenergjetik.

Neni 6

Ministri i Financave dhe ShA MEPSO do të lidhin Marrëveshje për sigurimin e garancisë së dhënë ndaj Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes për garanci ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Projekti për sektorin e energjetikës), (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë - Marrëveshje ndërkombëtare”, numër 48/94).

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.